Crna Gora
Uprava za statistiku

MONSTAT

2023 POPIS ПОПИС REGJISTRIMI

# UDHËZIM

PËR PËRDORIMIN E APLIKACIONIT PËR KONTROLLIN E KARAKTERISTIKAVE ETNO-KULTURORE TË GRUMBULLUARA NGA REGJISTRIMI I POPULLSISË, AMVISËRIVE DHE BANESAVE NË VITIN 2023

Podgorica, shtator 2024.

Ky udhëzim përcakton më hollësisht përdorimin e aplikacionit që do ta përdorin qytetarët për të kontrolluar të dhënat e tyre për karakteristikat etniko-kulturore të mbledhura nga Regjistrimi i Popullsisë, Amvisërive dhe Banesave.

Regjistrimi i Popullsisë, Amvisërive dhe Banesave është bërë në përputhje me Ligjin për Regjistrimin e Popullsisë, Amvisërive dhe Banesave ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 140/22 datë 16.12.2022, 105/23, datë 28.11.2023. ).

Në bazë të neneve 26a dhe 26b të Ligjit për Regjistrimin e Popullsisë, Amvisërive dhe Banesave ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 140/22, datë 16.12.2022, 105/23, datë 28.11.2023), është vendosur një softueri për të kontrolluar të dhënat e mbledhura gjatë regjistrimit, të cilat i referohen pyetjeve për: përkatësinë kombëtare ose etnike, fenë, gjuhën amtare, gjuhën që zakonisht flet personi.

Softueri për kontrollin e karakteristikave etnike dhe kulturore të grumbulluara nga Regjistrimi i Popullsisë, Amvisërive dhe Banesave në vitin 2023 mund ti qaseni me anë të linkut: https://popis2023.monstat.org/

*Më poshtë shpjegohet procesi i kontrollit të të dhënave tuaja dhe besueshmëria e tyre në bazën e të dhënave, duke i krahasuar me kopjen të Pyetësorit tuaj për Personin – Fletën e Regjistrimit.*

Duke klikuar në linkun e lartpërmendur hapet ekrani siç tregohet në Figurën 1




**Figurën 1.**

Në ekranin e paraqitur në figurën 1, në këndin e sipërm djathtas, ekziston opsioni për të zgjedhur gjuhën e ndërfaqes si dhe linkun për Udhëzuesin për Përdorimin e Softuerit.

Në fushën e zbrazët të quajtur **ID Statistikore**, duhet të vendosni saktë numrin nëntëshifror nga etiketa e ngjitur në kopjen e Pyetësorit tuaj për Personin (P1) – Fletën e Regjistrimit, siç tregohet në Figurën 2:




**Figurën 2.**

Mbasi futet ID Statistikore nga kopja e Pyetësorit për Personin – Fleta e Regjistrimit, klikohet në tastierë butoni **Vazhdoni** ose **Enter**.

Në rast se në kutinë ID Statistikore futët saktësisht numrin nëntëshofror, do tu mundësohet qasja në kutitë në pjesën e ekranit që quhet **Verifikimi shtesë**.

Në këtë pjesë të ekranit, është e nevojshme që **detyrimisht** të fusni një nga të dhënat identifikuese: *Komunën, Rrethin e Regjistrimit, Banesën*, e kjo nga kreu i Pyetësorit për Personin – Fletës së Regjistrimit, siç tregohet në Figurën 3.




**Figurën 3.**

Mbasi keni plotësuar një nga kutitë: *Komunën, Rrethin e Regjistrimit, Banesën*, është e nevojshme që të klikoni në butonin Kryeni verifikimin, si në Figurën 4.




**Figurën 4.**

Në rast se keni futur saktësisht ID Statistikore dhe një nga të dhënat *Komunën, Rrethin e Regjistrimit, Banesën*, do tu hapet ekrani si në Figurën 5.




Figurën 5

Koha e parashikuar për verifikimin e të dhënave të shfaqura në ekran (figura 5) dhe krahasimin e tyre me të dhënat nga Pyetësori për Personini – Fleta e Regjistrimit, është 60 sekonda. E njëjta gjë shfaqet në këndin e sipërm të djathtë të ekranit siç shihet në.

Procesi i verifikimit të të dhënave tuaja dhe besueshmërisë së tyre në bazën e të dhënave duke i krahasuar me kopjen e Pyetësorit tuaj për Personin – Fletës së Regjistrimit është shpjeguar më lart.

***<u>Në vijim vazhdojnë hapat në rast se nuk janë futur saktësisht të dhënat e kërkuara, në bazë të kopjes së Pyetësorit tuaj për Personin – Fletës së Regjistrimit.</u>***

Në kutinë ID Statistikore nuk fusni saktësisht numrin nga etiketa e ngjitur që gjendet në kopjen e Pyetësorit tuaj për Personin (P1) dhe klikoni butonin **Vazhdoni** ose **Enter**, në këndin sipër djathtas të ekranit do të shfaqet mesazhi siç tregohet në Figurën 6.




**Figurën 6.**

Tregimi i mesazhit të këndit sipër djathtas nga Figurën 6.



Në rast se numri nëntëshifror nga kopja e Pyetësorit Personal - Regjistrimi është futur saktë në fushën e ID Statistikore dhe informacioni nga kreu i kopjes së Pyetësorit për Personin është futur gabim në njërën nga rubrikat *Komuna, Rrethi i Regjistrimit, Banesa ose Personi*, pasi të klikoni në butonin **Kryej verifikimin**, do të hapet ekrani siç tregohet në Figurën 7.




**Figurën 7.**

Mesazhi që shfaqet në këndin sipër djathtas nga Figura 7.




Në rast të nevojës për një verifikim të ri, klikoni në buronin **Futeni përsëri** (i shënuar me shigjetë në Figurën 7), dhe më pas fusni përsëri të dhënat e kërkuara.

Në rast se, për çdo lloj arsyeje nuk mund tu qaseni të dhënave ose verifikoni se të dhënat Tuaja nuk janë njësoj si në kopjen e Pyetësorit për Personin –Fletën e Regjistrimit, Ju lutemi që të kontaktoni Drejtorinë e Statistikës në emailin: provjerapodataka@monstat.org ose në telefonat 020-230811 ose 068-851-500.

*Në vijim vazhdojnë informacione për kufizimin e qasjes tek të dhëna*

Të dhënat për të njëjtën ID Statistikore është e mundur që të verifikohen maksimalisht **tre** herë në të njëjtën ditë. Në rastin se tentoni katër ose më shumë herë, do tu hapet ekrani siç tregohet në Figurën 8.

Të dhënat për të njëjtën ID Statistikore mund t'i kontrolloni sërish pas 24 orësh.




**Figurën 8.**